

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Bordi i Kullimit, Blerje Kokë Tërheqëse për Rimorkiator ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
42415200-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,083,333 (tre milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

3,083,333 X 0.4=1,233,333 (një milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *”Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.* .

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, *nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”

2.2.3 Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (*sipas nenit 83 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020*) është 2% e fondit limit ose 61,667 (gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë.

2.2.4 Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2024 në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron

aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$3,083,333 \times 0.2 = 616,667$ (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikata që kërkohet duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit:

- **ISO 9001:2015** (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e certifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike dhe në varësi të zërave përkatës të preventivit. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mjetit sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë deklaratën që garancia e mjetit do të jetë: jo më pak se 1 vit nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor ku të përcaktoje dhe e pershkruaje qarte të gjithë termet dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, gjithashtu të jetë e targuar, me taksë të paguara dhe me doganë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 1 viti, malli objekt prokurimi do të përmbushë specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, jo për faj të Autoritetit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të marrë cdo defekt që mund të shfaqet brenda periudhës së garancisë.

2.3.6 Licencë: VII.3.B.1. “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove” ose ekuivalent.

Argumentim: Në bazë të ligjit nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licensimin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimetteknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës,anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumentave të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 14/06/2024

Njësia e Prokurimit